



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-134

**PËR LEGALIZIMIN DHE DORËZIMIN E ARMËVE, MUNICIONIT
DHE MJETEVE EKSPLOZIVE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR LEGALIZIMIN DHE DORËZIMIN E ARMËVE,
MUNICIONIT DHE MJETEVE EKSPLOZIVE**

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton të drejtën për personat fizik dhe juridik për legalizim të armës apo dorëzimin vullnetar të armëve, municionit, si dhe mjeteve eksplozive që i kanë në posedim të paligjshëm gjatë afatit kohor për legalizim dhe dorëzim të përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre në Republikën e Kosovës, të cilat do të përfshihen në aktivitetet gjatë legalizimit të

armëve dhe dorëzimit të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, si dhe për të gjithë personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në këtë proces.

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllim të këtij ligji termat, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura kanë kuptimin si në vijim:

1.1. **Organi kompetent** - Ministria e Punëve të Brendshme;

1.2. **Ministri** - nënkupton Ministrin e Punëve të Brendshme;

1.3. **Libreza** - nënkupton dokumentin me të cilin pajiset personi i cili ka deklaruar armën e paligjshme në posedim dhe ka iniciuar procedurën e legalizimit. Kjo librezë do të përdoret edhe si autorizim për transportim të armës nga vendqëndrimi te personi juridik i licencuar dhe anasjelltas;

1.4. **Kërkesa për legalizim** - nënkupton formularin i cili plotësohet me të dhënat e personit fizik ose personit juridik dhe armës me qëllim të legalizimit;

1.5. **Qendra Koordinuese Shtetërore (QKSH)** - është trup i përkohshëm i themeluar nga Ministri, i cili është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive;

1.6. **Personi juridik i licencuar** – nënkupton personin juridik të licencuar për tregtimin, riparimin, çaktivizimin dhe prodhimin e armëve sipas Ligjit për Armë.

2. Termat, shprehjet dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë përkufizuar në Ligjin për Armë.

Neni 4 Afati i legalizimit dhe dorëzimit vullnetar

1. Afati kohor për legalizim të armës do të jetë deri në gjashtë (6) muaj brenda një (1)viti, pas hyrjes në fuqi të këtij të ligji i cili përcaktohet me vendim të organit kompetent.

2. Afati kohor për dorëzimin vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive do të jetë deri në tre (3) muaj brenda dy (2) vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij të këtij ligji i cila përcaktohet me vendim të organit kompetent.

3. Afatet kohore sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, mund të vazhdohen ose ripërtërihen sipas nevojës dhe ndikimit që mund të ketë procesi i legalizimit dhe dorëzimit të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive me vendim të Qeverisë sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, organi kompetent do të realizojë fushata informimi dhe sensibilizimi për opinionin.

5. Për zbatim të këtij neni, organi kompetent do të nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin afateve dhe modaliteteve operative.

Neni 5 **Legalizimi i armëve**

1. Gjatë periudhës së legalizimit, personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, duhet të paraqiten në stacionin policor më të afërt në vendbanimin apo vendqëndrimin e tij dhe të deklaroj posedimin e armës të cilën nuk e ka regjistruar më parë, me ç'rast të njëjtit pajisen me librezë dhe kërkesë për legalizimin e armës.

2. Personi fizik sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të ketë mbushur moshën njëzetënjë (21) vjeçare dhe të paraqesë dëshminë që nuk paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë publike siç është përcaktuar në Ligjin për Armë.

3. Personi juridik duhet t'i plotësojë kriteret e përcaktuara sipas nenit 13 të Ligjit për Armë.

4. Arma duhet të jetë e kategorisë B,C ose D sipas Ligjit për Armë apo armë e kategorisë A, me qëllim të çaktivizimit të saj.

5. Personi fizik ose personi përgjegjës i personit juridik, sipas paragrafit 1. të këtij neni, i lëshohet librezë dhe i njëjti është i obliguar që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta dërgojë armën tek personi juridik i licencuar.

6. Personi juridik i licencuar obligohet ta ruaj armën dhe është përgjegjës për të verifikuar që arma nuk përbënë rrezik për sigurinë publike, t'i bëjë qitjen testuese dhe të vërtetojë nëse arma është shënjuar sipas nenit 56 të Ligjit për Armë. Nëse nuk përmbushen ndonjëra nga këto kushte, arma dhe librezë i dorëzohen organit kompetent dhe arma duhet të trajtohet sipas Ligjit për Armë.

7. Personi juridik nga paragrafi 6. i këtij neni është i obliguar të plotësojë dhe vulosë pjesën e tij në librezën për legalizim dhe të raportojë te organi kompetent brenda dy (2) ditësh.

8. Personi fizik ose personi përgjegjës i personit juridik, duhet t'ia dëshmojë stacionit policor veprimet e kryera sipas paragrafëve 5. dhe 6. të këtij neni, dhe të vazhdojë plotësimin e kërkesës me të dhëna shtesë.

9. Organi kompetent verifikon nëse arma nuk i përket dikujt tjetër sipas Ligjit për Armë.

10. Në rast se personi juridik i licencuar vërteton se janë përmbushur kushtet sipas paragrafit 6., organi kompetent e aprovon aplikacionin, aplikuesit i jepet pëlqimi nga stacioni policor për përfundimin e procesit të legalizimit dhe i njëjti mund ta marrë armën e cila do të shënjohej si armë e legalizuar sipas nenit 56 të Ligjit për Armë.

11. Personi juridik i licencuar e njofton organin kompetent për dorëzimin e armës brenda dy (2) ditësh.

12. Personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik në momentin kur merr pëlqimin, brenda periudhës një (1) vjeçare duhet të përmbushë të gjitha kriteret, sipas Ligjit për Armë për pajisje me leje përkatëse.

13. Gjatë periudhës kalimtare sipas paragrafit 12. të këtij neni, arma nuk mund të përdoret, të transportohet, të shitet apo për të njëjtën të blihet municion.

14. Për zbatimin e këtij neni organi kompetent nxjerrë akt nënligjor.

Neni 6

Kushtet e marrëveshjes së pajtueshmërisë

1. Në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, para marrjes së pëlqimit nga organi kompetent në lidhje me legalizimin, aplikuesi duhet të nënshkruajë marrëveshjen e pajtueshmërisë.

2. Kushtet për nënshkrimin e marrëveshjes së pajtueshmërisë janë si në vijim:

2.1. gjatë periudhës një (1) vjeçare aplikuesi duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret sipas Ligjit për Armë me qëllim të marrjes së lejes përkatëse;

2.2. gjatë periudhës një (1) vjeçare arma verifikohet në bazat e të dhënave përkatëse të forenzikës dhe nëse konstatohet që arma është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, organi kompetent informon pronarin rreth dorëzimit të armës;

2.3. arma e përshkruar në paragrafin 2. nën-paragrafin 2.2. të këtij neni, trajtohet në përputhje me Ligjin për Armët dhe pëlqimi revokohet.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesës dhe e drejta e ankesës

Shqyrtimi i kërkesave për legalizim dhe e drejta e ankesës bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Armë.

Neni 8

Dorëzimi i armëve, municioneve dhe mjeteve eksplozive

1. Gjatë periudhës së dorëzimit vullnetar, personat fizik mund t'i dorëzojnë vullnetarisht armët, municionin dhe mjetet eksplozive dhe të njëjtët nuk i merren të dhënat personale.

2. Dorëzimi i mjeteve eksplozive nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të raportohet dhe trajtohet nga organi kompetent.

3. Trajtimi i armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, të dorëzuara sipas paragrafit 1. të këtij neni e që kanë vlerë të veçantë historike dhe artistike do të rregullohen me procedura të veçanta.

4. Për zbatim të këtij neni organi kompetent nxjerrë akt nënligjor.

Neni 9

Gjatë periudhës së legalizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, për aq kohës sa zgjat periudha e përcaktuar me vendim sipas nenit 4, paragrafëve 1. dhe 2. të këtij ligji, do të pezullohet zbatimi i nenit 374 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 10

Qendra Koordinuese Shtetërore

1. Organi kompetent me vendim të Ministrit e themelon QKSH-në për koordinimin e aktivitetëve të dorëzimit vullnetar të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive.
2. Administrimi, ruajtja dhe evidentimi i armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive janë përgjegjësi e përbashkët e QKSH-së dhe organit kompetent.
3. Organi kompetent nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.

Neni 11

Dispozita ndëshkuese

1. Dënohet me gjobë pesëqind (500) euro personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik në rastet kur:
 - 1.1. nuk e sjell armën te personi juridik i licencuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas kërkesës së legalizimit sipas nenit 5 paragrafi 5. të këtij ligji;
 - 1.2. nuk raporton në stacionin policor sipas nenit 5 paragrafi 8. të këtij ligji;
 - 1.3. transporton armën pa librezë apo nuk e përdor rrugën më të shkurtër nga vendbanimi apo vendqëndrimi te personi juridik i licencuar.
2. Dënohet me gjobë një mijë (1000) euro personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik në rastet kur:
 - 2.1. nuk i përmbahet marrëveshjes sipas nenit 6;
 - 2.2. nuk i përmbush kriteret e Ligjit për Armë brenda periudhës kalimtare sipas nenit 5 paragrafi 12.
3. Dënohet me gjobë pesëqind (500) euro personi juridik në raste kur:
 - 3.1. nuk i ruan armët siç e përcakton Ligji për Armë;
 - 3.2. nuk e plotëson, vulosë aplikacionin apo informon organin kompetent sipas nenit 5 paragrafi 7. të këtij ligji.

4. Personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik i cili transporton, përdorë, shet armën, blen municion për armën apo nuk e ruan në mënyrë adekuate gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 5, paragrafi 12. të këtij ligji, do të ndëshkohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Kosovës, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

KAPITULLI II DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Për zbatimin e këtij ligji, organi kompetent brenda gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr akte nënligjore për:

1.1. përcaktimin e afateve dhe modaliteteve operative sipas nenit 4 të këtij ligji;

1.2. librezën, kërkesën dhe pëlqimin për legalizimin e armës dhe procedurat që duhet të ndiqen nga personi juridik i licencuar sipas nenit 5 të këtij ligji;

1.3. transportimi i armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive gjatë dorëzimit vullnetar dhe procedurat e trajtimit të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive me vlerë të veçantë historike dhe artistike sipas nenit 8 të këtij ligji;

1.4. përbërja, detyrat, dhe përgjegjësitë e QKSH-së për administrimin, ruajtjen dhe evidentimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive sipas nenit 10 të këtij ligji.

2. Për zbatimin e këtij ligji, organi kompetent mund të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore.

Neni 13 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-134
31 mars 2017**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI